

Nr.13 Dhjetor 2019

I vit nga konstitutimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), fillon veprimtarinë Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

- *Këshilli i Lartë i Prokurorisë emëron 8 prokurorët e parë në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (KKKO) dhe zgjedh Drejtuesin e këtij institucioni*

Në zbatim të hapave të ndërmarrë në [mbledhjen e datës 25 tetor 2019](#), Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka përfunduar emërimin e 8 prokurorëve të parë të posaçëm në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (të konfirmuar në të dyja shkallët e rivlerësimit). [Propozimet](#) e Komisionit të Posaçëm për ngritjen e SPAK pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të cilat u miratuan unanimisht, përfshinin finalizimin e ngritjes në detyrë dhe emërimin e 8 prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme brenda 30 ditëve ose brenda muajit nëntor 2019 si edhe përgatitjen e akteve (vendimeve) të nevojshme për emërimin e tyre.

Në këtë mënyrë, KLP në mbledhjen e datës [25 nëntor 2019](#) pasi ka verifikuar plotësimin e të gjitha kushteve dhe kriterëve të parashikuara në [Ligjin 95/2016](#) dhe në referencë të vendimit [“Për miratimin e listës me renditjen e kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme”](#) ka [miratuar projekt-aktet](#) respektive për emërimin e 8 prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme për një mandat 9 (nëntë) vjeçar pa të drejtë riemërimi.

8 prokurorët e parë të emëruar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë janë [betuar para Presidentit të Republikës](#) në datën 19 dhjetor 2019, një ngjarje e cila është përshëndetur edhe nga [përfaqësuesit ndërkombëtarë në Tiranë](#). Emërimi i 8 prokurorëve të parë në SPAK ka shënuar në këtë mënyrë fillimin zyrtar të punës të një prej institucioneve kryesore të hetimit të veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar. Hapi kryesor vijues për funksionimin eficient të këtij organi ka patur të bëjë më hapjen e garës për shprehjen e interesit për pozicionin e Drejtuesit të SPAK.

SPAK Info Nr. 13 ka në fokus zhvillimet kryesore, të cilat finalizuan ngritjen e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Gjykatave të Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Emërimi i 8 prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme dhe caktimi i 13 gjyqtarëve përkohësisht si edhe 5 gjyqtarëve të tjerë në mënyrë të përhershme, sollën fillimin e veprimtarisë së këtyre institucioneve.

Për shumë informacion mbi zbatimin në kohë të hapave ligjorë në drejtim të ngritjes së Gjykatave të Posaçme dhe SPAK mund të lexoni Buletinet 3-mujore SPAK Monitor të publikuara në faqen e CSDG: www.csdgalbania.org

Publikimet realizohen në kuadër të projektit “Monitorimi dhe vlerësimi i procesit të ngritjes dhe funksionimit të Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe Strukturës së Posaçme SPAK, nëpërmjet hulumtimit, informimit, ndërgjegjësimin dhe mbështetjes në ngritjen e kapaciteteve administrative”, i mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

Ndër masa të tjera në kuadër të ngritjes së Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar kanë qenë edhe ato administrative dhe procedurale të ndërmarra nga Prokurori i Përgjithshëm, por edhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Në këtë mënyrë nëpërmjet [Udhëzimit të datës 10 dhjetor 2019](#) Prokurori i Përgjithshëm ka udhëzuar mbi unifikimin e masave administrative dhe procedurale penale në Prokuroritë për Krime të Rënda dhe në Prokuroritë e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm për transferimin e procedimeve/çështjeve në hetim sipas kompetencave lëndore dhe/ose tokësore me krijimin dhe fillimin e funksionimit të Prokurorisë së Posaçme KKKO. Detyrimet e parashikuara kanë përfunduar zbatimin e tyre brenda datës 19 dhjetor 2019.

Rreth [120 dosjeve](#) kalojnë nga Prokuroria e Krimeve të Rënda drejt Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, 15 çështje për secilin nga 8 prokurorët e emëruar. Ndërkohë, [270 dosje](#) të tjera do të transferohen në prokuroritë e rretheve gjyqësore, në të cilat ka nisur çështja si edhe në Prokurorinë e Tiranës.

Ndërkohë, me fillimin e veprimtarisë së Prokurorisë së Posaçme KKKO, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka [miratuar vendimet për transferimin e prokurorëve](#) të Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda. Prokurorët e këtyre prokurorive janë emëruar në Prokurorinë e Shkallës së Parë, Tiranë dhe në rrethe të tjera gjyqësore.

Nr.	Prokurorët e transferuar nga Prokuroria e Shkallës së Parë për Krime të Rënda	
1.	Arens Çela	transferuar në Prokurorinë e Shkallës së Parë, Tiranë
2.	Blerim Tominaj	transferuar në Prokurorinë e Shkallës së Parë, Tiranë
3.	Besim Hajdarmataj	transferuar në Prokurorinë e Shkallës së Parë, Tiranë
4.	Doloreza Musabelliu	transferuar në Prokurorinë e Shkallës së Parë, Tiranë
5.	Elisabeta Imeraj	transferuar në Prokurorinë e Shkallës së Parë, Tiranë
6.	Manjola Kajana	transferuar në Prokurorinë e Shkallës së Parë, Tiranë
7.	Vladimir Mara	transferuar në Prokurorinë e Shkallës së Parë, Tiranë
8.	Sonila Muhametaj	transferuar në Prokurorinë e Shkallës së Parë, Tiranë
9.	Pranvera Pustina	transferuar në Prokurorinë e Shkallës së Parë, Tiranë
10.	Përparim Kulluri	transferuar në Prokurorinë e Shkallës së Parë Shkodër
11.	Eugen Beçi	transferuar në Prokurorinë e Shkallës së Parë Korçë
12.	Donika Prela	transferuar në Prokurorinë e Shkallës së Parë në Tiranë
13.	Anton Martini	transferuar në Prokurorinë e Shkallës së Parë Tiranë
14.	Dritan Prençi	transferuar në Prokurorinë e Shkallës së Parë Tiranë
	Prokurorët e transferuar nga Prokuroria e Apelit për Krime të Rënda	
1.	Isa Jata	transferuar në Prokurorinë e Shkallës së Parë Tiranë
2.	Artan Bajrami	transferuar në Prokurorinë e Apelit Tiranë

* Burimi: Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP): <https://klp.al/2019/12/12/vendimet-e-marra-ne-seancen-plenare-te-dates-12-dhjetor-2019/>

Zgjedhja e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme: 3 kandidatë në garë për postin e Drejtuesit të SPAK

- *KLP ka votuar dhe finalizuar në 19 dhjetor 2019 zgjedhjen e Drejtuesit të parë të SPAK*

Në vijim të [propozimeve](#) të Këshillit të Lartë të Prokurorisë të datës 25 tetor 2019, ishte edhe hapja e menjëhershme e garës nga ana e 8 prokurorëve tashmë të emëruar për pozicionin e Drejtuesit për një mandate 3-vjeçar. Në këtë mënyrë, KLP hapi [garën për shprehjen e interesit](#) nga ana e 8 prokurorëve të emëruar për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme. Afati i procesit të aplikimeve zgjati deri në datën 10 dhjetor 2019, ndërkohë që KLP miratoi edhe [“Metodologjinë për vlerësimin e kandidatëve për Drejtues të Prokurorisë së Posaçme”](#), e cila parashikonte vlerësimin e kandidatëve me 0 deri në 3 pikë bazuar në plotësimin e [7 kritereve kryesore](#). Ndërkohë, përveç këtyre kritereve Këshilli vendosi një instrument shtesë vlerësimi, i cili nuk ishte pjesë e pikëzimit dhe i cili konsistonte në zhvillimin e intervistave me kandidatët për drejtues të SPAK.

Me përfundimin e afatit të aplikimeve për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka [njoftuar](#) mbi 3 kandidatët, të cilën shprehën interesin për të aplikuar për këtë pozicion, specifikisht prokurorët: Arben Kraja, Edvin Kondili dhe Altin Dumani. Kandidatët dorëzuan pranë Këshillit letrën e motivimit, përmes së cilës kanë shprehur interesin për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, letrën mbështetëse (shpjeguese) për standardet 1,2,3,4,5,7 të parashikuara në [metodologjinë e miratuar me vendim të KLP nr.237, datë 25.11.2019](#) si dhe vizionin ose planin e besueshëm për ndërtimin e Prokurorisë së Posaçme si një institucion funksional dhe efektiv.

Në vijim të këtyre hapave KLP nëpërmjet [njoftimit të datës 17 dhjetor 2019](#) ka përcaktuar datën **18 dhjetor 2019** për zhvillimin e intervistave me tre kandidatët në garë për Drejtues të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK). Intervistat me 3 kandidatët u rregjistruan me audi dhe video dhe gjatë zhvillimit të tyre prokurorët kanë [paraqitur dhe prezantuar platformën](#) e tyre për drejtimin e Prokurorisë së Posaçme.

Në përfundim të intervistave, në [mbledhjen e datës 19 dhjetor 2019](#) KLP me shumicë votash ka miratuar projekt-vendimin “Për emërimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar” dhe Kryetari i KLP ka shpallur të hapur votimin për secilin kandidat sipas rendit alfabetik. Sipas votimit të realizuar nga anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i pari në listë është renditur kandidati Arben Kraja me 6 vota, ndjekur nga Altin Dumani me 4 vota dhe Ervin Kondili me 1 votë.

Ndër pikat kryesore që Drejtuesi i zgjedhur renditit gjatë [prezantimit të platformës](#) së tij përfshiheshin: 1) garancia ligjore, pavarësia në vendimmarrje për çdo prokuror, përfshirë edhe drejtuesin. 2) garancitë si përzgjedhje nga ana e anëtarëve të Këshillit dhe 3) vullneti i të gjithëve për të zbatuar ligjin me korrektësi.

Drejtuesi i parë i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Arben Kraja ka marrë detyrën pas betimit në Presidencë dhe është [prezantuar zyrtarisht](#) nga Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë në ambientet e ish-Prokurorisë së Krimeve të Rënda, në prezencën e kryeprokurorit Olsian Çela, kryetarëve të komisioneve të këtij Këshilli si dhe ish-drejtueses së Krimeve të Rënda, prokurores Donika Prea.

Ashtu siç [është theksuar edhe më parë](#), Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar do të përcaktojë në vijim organigramën dhe numrin e prokurorëve të posaçëm për fillimin e punës së institucionit.

Ndërkohë, nisur nga nevoja për të koordinuar veprimtarinë me Gjykatat e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në seancat gjyqësore të pezulluara si rezultat i ngritjes së institucioneve të reja, [është kërkuar të marrin pjesë prokurorët e rinj](#) të emëruar në Prokurorinë e Posaçme KKKO.

Dy nga vendimet e para që pritet të merren nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme janë caktimi i dosjeve që duhet të ndjekin prokurorët e posaçëm bazuar në specializimin e tyre si edhe miratimi i Rregullores për funksionimin e Prokurorisë së Posaçme KKKO. Drejtuesi i SPAK do të koordinojë punën e njërive pranë Prokurorisë së Posaçme me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit brenda dhe jashtë vendit, me shërbimet e inteligjencës si edhe autoritete të tjera kompetente.

Pranë Prokurorisë së Posaçme KKKO do të ngrihen **5 sektorë kryesorë**, të cilët do të plotësohen me staf respektiv: 1) Sektori i Dokumentacionit; 2) Sektori i Ekspertizës; 3) Sektori i Hetimit Financiar; 4) Sektori i Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Ndërlidhjes për Hetimet e Përbashkëta dhe 5) Sektori për Asistencën për Individët me Status të Posaçëm. Ndërkohë dy pozicione mjaft të rëndësishme për koordinimin e veprimtarisë së SPAK janë **Kancelari i institucionit dhe Koordinatori për Marrëdhënien me Mediat**, të cilët do të zgjidhen në vijim. Kancelari i Prokurorisë së Posaçme, i cili është edhe nëpunësi civil më i lartë i këtij institucioni, përgjigjet para Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, por gjithashtu edhe Koordinatori i Marrëdhënieve me Mediat është i vetmi person i autorizuar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme për të komunikuar me mediat në emër të Prokurorisë së Posaçme, në lidhje me hetime apo çështje penale. Sektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta në Prokurorinë e Posaçme konsiderohet si një nga sektorët më të rëndësishëm të SPAK. Për këtë arsye drejtuesi i tij është një prokuror i posaçëm, i cili caktohet nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme për një periudhë 3-vjeçare.

Ngritja e **Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH)** do të jetë gjithashtu një nga fazat më të rëndësishme të procesit në funksion të plotësimit të strukturës së SPAK. Si një strukturë e specializuar e policisë gjyqësore, **BKH do të përbëhet nga 60 hetues**. [Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka shpalluar](#) me herët në kohë informacionin dhe thirrjen për të gjithë të interesuarit, të cilët plotësojnë kushtet e sigurisë dhe ato ligjore për hetues të BKH dhe për pozicionin e Drejtorit të BKH. Ky i fundit do të propozohet KLP-së nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme së bashku me dy prokurorë të posaçëm.

Edhe zëvendësdrejtori i BKH, i cili përzgjidhet nga rradhët e hetueseve të Byrosë, merr pëlqimin e Drejtorit të BKH-së si edhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme. Për funksionimin e brendshëm të institucionit, dy drejtuesit e Prokurorisë së Posaçme dhe BKH nxjerrin urdhra të cilat lidhen me organizimin e Byrosë. **Një komision i përbërë nga ekspertë të drejtësisë penale, të caktuar nga misionet e Bashkimit Europian dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, do të japë udhëzime dhe këshilla për themelimin dhe zhvillimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit**, për një periudhë 2-vjeçare, duke nisur nga momenti i themelimit të kësaj Byroje.

Fillon funksionimi i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJPSHPKKO) dhe i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJPAKKO)

- *Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos për fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme si edhe pozicioneve të Kryetarëve dhe Kancelarëve të Gjykatave të Posaçme*

Nevoja e ngritjes dhe funksionimit të harmonizuar të institucioneve të reja të hetimit dhe gjykitimit për veprat penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, ka bërë që edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor të marrë vendimet respektive në drejtim të ngritjes së Gjykatave të Posaçmë KKKO. Në [mbledhjen e datës 18 dhjetor 2019](#) KLGJ ka miratuar [vendimin](#) për fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si dhe disa vendimeve të tjera individuale për sistemimin në pozicion të gjyqtarëve të Gjykatave për Krimet e Rënda, të cilat nga data 19 dhjetor 2019 kanë pushuar së funksionuari si të tilla.

Duke qenë se në ndryshim nga emërimi i prokurorëve të posaçëm, gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda ju mundësohet emërimi i përkohshëm deri në konfirmimin në detyrë në të dyja shkallët nga institucionet e rivlerësimit kalimtar, KLGJ ka vendosur caktimin e përkohshëm pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të [12 \(dymbëdhjetë\) gjyqtarëve](#) të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, për të cilët vijon procesi i rivlerësimit kalimtar apo nuk ka ende një vendim përfundimtar për konfirmimin në detyrë.

Ndërkohë, Këshilli ka vendosur edhe caktimin në mënyrë të përhershme të [5 \(pesë\) gjyqtarëve dhe të përkohshëm të 1 \(një\) gjyqtari](#) të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

	Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJPSHPKKO)		Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJPAKKO)
Gjyqtarë të caktuar në mënyrë të përkohshme në GJPSHPKKO	1. Daniela Shirka	Gjyqtarë të caktuar në mënyrë të përhershme në GJPAKKO	1. Albana Boksi
	2. Etleva Dede		2. Nertina Kosova
	3. Flora Haredinaj		3. Saida Dollani
	4. Ilirjana Oldashi		4. Dhimitër Lara
	5. Irena Gjokaj		5. Sokol Binaj
	6. Marsela Balili		6. Nure Dreni (caktuar përkohshëm)
	7. Miliana Muçaj		
	8. Ardit Mustafaj		
	9. Bib Ndreca		
	10. Fran Prendi		
	11. Klodian Kurushi		
	12. Sandër Simoni		

* Burimi: Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ): <http://www.klgj.all/component/k2/njoftim-per-media-18-12-2019>

Gjithashtu, nisur nga pushimi së funksionuari i Gjykatave të Krimeve të Rënda, KLGJ ka vendosur për transferimin e [5 \(pesë\) gjyqtarëve](#) të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe [2 \(dy\) gjyqtarëve](#) të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda pranë disa gjykatave të apelit apo të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, duke filluar nga data 19 dhejtor 2019 dhe deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Në rast të konfirmimit në detyrë nga ky i fundit, gjyqtarët e transferuar gëzojnë të drejtën e zgjedhjes për t'u transferuar në çdo pozicion që do të jetë i lirë në atë moment apo që pritet të bëhet i lirë brenda gjashtë muajve, respektivisht në gjykatat e apelit apo të shkallës së parë me juridiksionin të përgjithshëm.

Nr.	Gjyqtarët e transferuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda	
1.	Luan Hasneziri	pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës
2.	Dritan Hallunaj (anëtar i KLGJ)	pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë
	Gjyqtarët e transferuar nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda	
1.	Fehmi Petku	pranë Gjykatës së Apelit Durrës
2.	Gjovalin Përnoça	pranë Gjykatës së Apelit Vlorë
3.	Gurali Brahimllari	pranë Gjykatës së Apelit Korçë
4.	Idriz Mulkurti	pranë Gjykatës së Apelit Vlorë
5.	Dhurata Haveri	pranë Gjykatës së Apelit Durrës

* Burimi: Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ): <http://www.klgj.al/component/k2/njoftim-per-media-18-12-2019>

[Selia](#) e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë dhe Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar do të jetë në Tiranë, në ndërtesën aktuale të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Apelit për Krimet e Rënda. Ndërkohë, në kuadër të marrjes së masave të tjera administrative dhe njerëzore, KLGJ ka marrë vendime edhe sa i përket Kryetarëve dhe Kancelarëve në detyrë në të dyja Gjykatat e Krimeve të Rënda (shkalla e parë dhe e apelit).

Specifikisht, KLGJ ka [vendosur](#) vazhdimin e pozicionit të Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndërkohë që ka vendosur thirrjen e menjëhershme të mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve nga gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë, për të zgjedhur zëvendëskryetarin e Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Edhe [Kancelarët](#) në detyrë të Gjykatave të Krimeve të Rënda (shkalla e parë dhe e apelit) do të vazhdojnë të qëndrojnë në këtë pozicion në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar deri në zgjedhjen e Kancelarëve të rinj.

Gjatë periudhës së funksionimit të tyre, Gjykatat e Krimeve të Rënda morën masat në drejtim të kalimit të çështjeve mbi veprat penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, të cilat do të gjykohen nga Gjykatat e Posaçme KKKO. **24 dosje do ti kalojnë përshtyrtim** Gjykatave të Posaçme KKKO (Aneks III), ndërkohë që për [37 të tjera](#) është shpallur mos kompetenca e gjykimit nga Gjykatat e Posaçme. [Gjithashtu](#) është përshtatur sistemi i ri i sigurisë me të gjitha elementet e reja duke ridimensionuar sistemin e kamerave të vëzhgimit, sistemin e identifikimit të hyrjeve të paautorizuara, sistemin e sinjalistikës akustike dhe aksesit të hyrje-dalje në institucion si edhe janë dizenuar tabelat si dhe ka përfunduar instalimi në të gjithë perimetrit të godinës me kamera sigurie si dhe aparatura të tjera bashkohore, të cilat do të monitorojnë sistemin e sigurisë në ambientet e ish-Gjykatave të Krimeve të Rënda.


Procesi i rivlerësimit dhe vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit (KPA) mbeten thelbësore për plotësimin e vendeve vakante në organet e reja anti-korrupsion

- Të paktën 10 prokurorë janë parashikuar të jenë në përbërje të Prokurorisë së Posaçme KKKO, ndërkohë që Gjkatat e Posaçme të Shkallës së Parë dhe e Apelit KKKO do të përbëhen nga 16 dhe 11 gjyqtarë respektivisht

Megjithëse tashmë kanë filluar veprimtarinë e tyre organet e reja të hetimit dhe gjyqimit të veprave penale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, ende Prokuroria dhe Gjykatat e Posaçme KKKO nuk janë të përbëra nga numri ligjor i kërkuar për prokurorët dhe gjyqtarët e emëruar në këto institucione. Në përbërje të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar janë parashikuar të emërohen të paktën 10 prokurorë dhe ashtu sikurse është përmendur më lart, me zgjedhjen e Drejtuesit të këtij institucioni do të jetë e mundur të përcaktohet edhe struktura dhe numri i prokurorëve, i cili për një sërë arsyesh objektive duke përfshirë edhe ngarkesën e institucionit mund të jetë më i madh se 10.

Edhe në rastin e Gjykatave të Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Orgaizuar nuk është plotësuar numri i parashikuar në legjislacionin përkatës, i përcaktuar edhe në [vendimin e datës 18 dhjetor 2019](#) të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në këtë mënyrë, Gjykata e Shkallës së Parë KKKO do të përbëhet nga 16 gjyqtarë, ndërkohë që aktualisht KLGJ ka caktuar përkohësisht vetëm 12 prej tyre. Konfirmimi i përhershëm i këtyre të fundit është i mundur vetëm me konfirmimin e tyre në detyrë nga të dyja shkallët e procesit të rivlerësimit. Sa i përket Gjykatës së Posaçme të Apelit KKKO numri i gjyqtarëve do të jetë 11. Aktualisht KLGJ ka caktuar vetëm 5 prej tyre në mënyrë të përhershme dhe 1 të emëruar përkohësisht si rezultat i procesit të rivlerësimit.

Duke marrë në konsideratë përcaktimet ligjore për plotësimin e vendeve vakante për prokurorë dhe gjyqtarë të posaçëm, por edhe ngarkesën dhe rëndësinë e çështjeve, ecuria dhe funksionimi eficient i organeve të reja të drejtësisë do të jetë i ndërlidhur me plotësimin në kohë të këtyre pozicioneve. Ritmet e procesit të rivlerësimit, por gjithashtu edhe numri i konfirmimeve në detyrë në të dyja shkallët mbeten faktorë të rëndësishëm dhe me ndikim në këtë drejtim.



* Burimi: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (www.kpk.al)

I. Statusi i vetting-ut për gjyqtarët e Gjykatave të Posaçme KKKO

Statusi i vetting-ut për gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë KKKO					
		Seanca Dëgjimore	Vendimi i KPK	Vendimi i IKP	Vendimi i KPA
1.	Sandër Simoni		Në proces rivlerësimi		
2.	Ardit Mustafaj		Në proces rivlerësimi		
3.	Irena Gjoka		Në proces rivlerësimi		
4.	Daniela Shirka	07.11.2019	Konfirmuar në detyrë		
5.	Etleva Deda		Në proces rivlerësimi		
6.	Flora Hajredinaj		Në proces rivlerësimi		
7.	Fran Prendi		Në proces rivlerësimi		
8.	Ilirjana Olldashi	02.12.2019	Konfirmuar në detyrë		
9.	Marsela Balili		Në proces rivlerësimi		
10.	Bib Ndreca		Në proces rivlerësimi		
11.	Miliana Muça		Në proces rivlerësimi		
12.	Klodian Kurushi	05.12.2019	Konfirmuar në detyrë		
Statusi i vetting-ut për gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme të Apelit KKKO					
1.	Nertina Kosova	17.07.2018	Konfirmuar në detyrë	Vendimi i KPK ankimuar në KPA	Konfirmuar nga KPA
2.	Nure Dreni		Në proces rivlerësimi		
3.	Saida Dollani	20.06.2019	Konfirmuar në detyrë		
4.	Dhimitër Lara	27.05.2019	Konfirmuar në detyrë		
5.	Sokol Binaj	17.05.2019	Konfirmuar në detyrë		
6.	Albana Boksi	04.04.2019	Konfirmuar në detyrë		

* Statusi i rivlerësimit është përditësuar për herë të fundit në datën 22 dhjetor 2019

II. Statusi i vetting-ut për 14 kandidatët të renditur për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

Statusi i vetting-ut për 15 kandidatët e renditur për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar					
		Seanca Dëgjimore	Vendimi i KPK	Vendimi i IKP	Vendimi i KPA
1.	Altin Dumani	30.07.2019	Konfirmuar në detyrë		
2.	Anton Martini		Në proces rivlerësimi		
3.	Elizabeta Imeraj		Në proces rivlerësimi		
4.	Arben Kraja	13.12.2018	Konfirmuar në detyrë		
5.	Doloreza Musabelliu		Konfirmuar në detyrë		
6.	Klodjan Braho	25.07.2019	Konfirmuar në detyrë		
7.	Enkeleda Millonai	13.06.2019	Konfirmuar në detyrë		
8.	Manjola Kajana	18.06.2019	Konfirmuar në detyrë	Vendimi i KPK ankimuar në KPA	Në proces
9.	Edvin Kondili	06.06.2019	Konfirmuar në detyrë		
10.	Ened Nakuçi	06.06.2019	Konfirmuar në detyrë		
11.	Elida Kaçkini	16.07.2019	Konfirmuar në detyrë		
12.	Ndini Tavani	07.10.2019	Shkarkuar nga KPK		
13.	Behar Dibra	20.06.2019	Konfirmuar në detyrë		
14.	Anita Jella	04.10.2019	Konfirmuar në detyrë		

* Statusi i rivlerësimin është përditësuar për herë të fundit në datën 22 dhjetor 2019

III. Informacion në lidhje me dosjet që qëndrojnë në gjykim me krijimin e Gjykatës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Shkalla e Parë

Nr.	Çështje penale që qëndrojnë në gjykim me krijimin e Gjykatës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Shkalla e Parë, sipas të pandehurve	Akuza sipas Kodit Penal
1.	Domart Konjari	283/a/2, 287, 333/a
2.	Reshat Rradhima	284, 333/a
3.	Klaudio Veizaj	283/a/2, 333/a
4.	Festim Lelaj, Skender Siqeca, Arbi Mustafa dhe Sokol Hamzallari	283/a/1, - 28/4, 333/a
5.	Adjel Caushaj, Artur Riza, pezulluar	283/a/1, - 28/4, 333/a
6.	Juri Bedinaj, Harmelindo Tufa dhe Emiljano Cili	283/a/1, - 28/4, 333/a
7.	Gentjan Doda	319
8.	Aleks Pepa	139, 333/a, 334
9.	Marko Bushi, Shpetim Lika	283/a/2, 333/a
10.	A. Kocerri	283/a/1, - 28/2, 333/a
11.	Moisi Habilaj, Florian Habilaj, Nezar Seiti, Amarildo Sulaj, Sabaudin Celaj, Tigrens Mezuraj, Fatmir Minaj, Maridian Sulaj	283/a/1, - 28/2, 333/a
12.	Elton Halipaj dhe EfthymioUs Eftimiu	78/2, 333/a
13.	Altin Hoxhallari	78/2, 333/a
14.	Gjergji Kohila, Sokol Bode	283/a/1, - 28/4, 333/a
15.	Alerjo Dushku, Albert Arraj, Imir Vila, Eduart Kume	140, 333/a
16.	Kastriot Deda (e pezulluar)	140, 333/a
17.	Ilir Myrtaj, Alfred Myrtaj, Mario Myrtaj, Arben Kadiu, Florian Hysenaj, Gentjan Stojku, Shkelqim Mema, Keldi Beshi, Albert Xhelilaj, Ismail Alushani	298/3, 333/a
18.	Arber Cekaj, Dolando Lushaj dhe Armando Pezaku	283/a/1, - 28/4, 333/a
19.	Leonora Dushku etj (40 persona)	298/3, 333/a/2, 334
20.	Enxhi Koci etj (11 persona)	298/3, 333/a/2, 334
21.	Gazmend Garupi, Haxhi Ramadani, Sotiraq Andoni, Bledjan Ramadani, Eduart Shima, Pellumb Pali, Shpetim Kiri, Nikolla Mano	298/3, 333/a/2, 334
22.	Ramadan Dushaj, Rezart Cacani etj (12) persona	283/a/1, 333/a, 334
23.	Gentjan Duraku	134/1, 333/a
24.	Spartak Cocoli, Ervin Hysaj, Ernest Duro	319, 25